

Për: ✓ **Urdhërin e Farmacistëve të Shqipërisë
Unionit të Biznesit Farmaceutik
Shoqatës Distributorve Farmaceutikë të Shqipërisë**

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës Tuaj me nr.prot., 594 datë 31.07.2015, potokolluar pranë Fondit me Nr.2705, datë 04.08.2015 ju kujtojme se:

Duke marrë parasysh problematiken e bërë prezent nga Urdhri i Farmacistëve me shkresën nr. 824/3 prot., datë 24.12.2014, për pamundësinë e pajisjes së farmacistëve me certifikatën e drejtuesit teknik dhe licensës nga ana e Urdhrit të farmacistëve, për shkak të afatit të përcaktuar për njohjen e krediteve nga sistemi i edukimit në vazhdim, nga ana e Fondit u udhëzua që lidhja e kontratave me subjektet farmaceutike do të bëhej deri më 30.6.2015. Pas kësaj date të gjitha subjektet që dëshironin vazhdimin e marrëdhënieve kontraktuale me Fondin duhet të paraqisnin dokumentacionin pwrkatws (çertifikatwn e ushtrimit tw profesionit) të lëshuar nga Urdhri i Farmacistëve.

Ndërkohë Fondi është informuar nëpërmjet njoftimit zyrtar në faqen e internetit të QKEV-së, (www.qkev.gov.al/sq/te-reja), ku të gjithë ata profesionitë të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet e certifikimit për periudhën 2010-2014, janë të detyruar të kryejnë Provimin e Çertifikimit, bazuar në Rregulloren për Organizimin e Provimit të Riçertifikimit. Afati i dhënies së provimit të certifikimit do të jetë Tetor 2015.

Gjithashtu nga ana juaj me shkresës me nr. 420 prot., datë 25.06.2015 na është kërkuar shtyrja e vlefshmërisë së certifikatave për Nd/Farmacistët deri në datën 31.12.2015.

Nr. Mbwshtetur në sa më sipër dhe me qëllim vijimin e shërbimit ndaj pacientëve, Fondi ka vendosur shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kontratës së lidhur me subjektet farmaceutike deri në datën 31.12.2015.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Milva Ekonomi
Drejtoreshë e Përgjithshme
(E Komanduar)

